



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1276/7 prot

Tiranë, më 20.06.2025

VENDIM

Nr. 19, datë 20.06.2025

PËR
URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Televizioni “Ora News”, përfaqësuar nga znj. (në vijim “ankuesja”), ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) formularët e ankesave me nr. 1276 prot., datë 22.04.2025 dhe nr. 1371 prot., datë 12.05.2025, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik/Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (në vijim “Autoriteti Publik”).

Duke qenë se, ankesat lidhen me të njëjtin dokument dhe i drejtohen të njëjtit Autoritet Publik, Komisioneri çmon trajtimin e tyre në një vendim të vetëm.

Ankuesja, me anë të kërkesës nr. 37 prot., datë 03.04.2025, depozituar në adresën elektronike besjan.osmanaj@aku.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. *Nga analizimi që i ka bërë AKU qumështit nga 1 marsi 2025 deri në 1 prill, si kanë dalë rezultatet?*
2. *Në përgjigjet e rezultatit të analizave të kësaj periudhe kohore, a ka rezultuar përmbajtje tej normës së lejuar të aflatoksinës?*
3. *Nëse po, lutem të na informoni në mënyrë specifike se te cilat mostra qumështi ka rezultuar niveli i lartë i aflatoksinës?*
4. *Çfarë masash konkrete ka marrë AKU në ndjekje të kësaj problematike?*

Ndërkohë, bazuar në përgjigjen e datës 11.04.2025, ku është bërë me dije se në analizat që Autoriteti Kombëtar i Ushqimit i ka kryer qumështit, kanë rezultuar kampione me prani të Aflatoksinës M1, me anë të kërkesës nr. 44, datë 22.04.2025, depozituar në adresën elektronike të sipërcituar, ka kërkuar nga Autoriteti Publik, t'i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni lidhur me:

1. *Te cilat mostra qumështi u konstatua prania e Aflatoksinës M1?*
2. *Sa ka qenë sasia totale e qumështit me Aflatoksinë nga janri deri në prill 2025?*
3. *Sa u shit?*
4. *Sa është në total sasia e qumështit të bllokuar e cila do të asgjësohet?*
5. *Deri në këtë moment sa qumësht është asgjësuar?*
6. *Çfarë masash administrative u morën ndaj subjekteve që hodhën në treg produktin e pasigurt?*

Autoriteti Publik, për sa i përket kërkesës së parë, me e-mail-in datë 11.04.2025, i ka kthyer përgjigje ankueses duke sqaruar se: *"...Lidhur me pikën 1, sqarojmë fillimisht parimet bazë të Legjislacionit në fuqi i cili trajton se:*

- *"Kontroll zyrtar" është çdo kontroll për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë.*
- *"Operator i biznesit ushqimor" është çdo person fizik ose juridik, i regjistruar për të kryer veprimtari, që lidhen me biznesin ushqimor, përgjegjës për të siguruar se kërkesat e ligjit të ushqimit janë arritur në biznesin ushqimor të kontrolluar prej tij.*
- *Operatorët e biznesit ushqimor mbajnë përgjegjësi për çdo dëmtim të shëndetit të njerëzve, të shkaktuar nga konsumi i ushqimit të rezultuar i pasigurt, në të gjitha fazat e prodhimit, të përpunimit dhe shpërndarjes.*
- *Kontrolli zyrtar i ushqimit dhe ushqimit për kafshë bëhet nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.*
- *Kontrolli zyrtar i ushqimeve përfshin një ose më shumë nga veprimtaritë siç është dhe marrja e mostrave dhe kryerja e analizave.*

Në kuadër të planeve zyrtare të marrjes së mostrës me bazë risku, trupat inspektuese kanë marrë dhe kanë analizuar kampione qumështi për prani të treguesit për Aflatoksinë M1 ndër të cilat ka patur dhe raste jo konforme.

2- Në përgjigjet e rezultatit të analizave të kësaj perjudhe kohore a ka rezultuar përmbajtje tej normës së lejuar të aflatoksinës? Nga rezultatet e kampioneve të qumështit të analizuara në ISUV, kanë rezultuar edhe kampione me prani të Aflatoksinës M1.

3- Nëse po, lutem të na informoni në mënyrë specifike se te cilat mostra qumështi ka rezultuar niveli i lartë i aflatoksinës? Mostrat e qumështit janë marrë në tregtim dhe përpunim në mënyrë rastësore të prodhuara nga subjekte të ndryshme ku sipas legjislacionit në fuqi janë marrë të gjitha masat duke ndjekur gjurmueshmërinë deri tek fermeri.

4- Çfarë masash konkrete ka marrë AKU në ndjekje të kësaj problematike? Në lidhje me mostrat të cilat kanë rezultuar jo konforme për praninë e Aflatoksinës M1 nga ana e trupave inspektuese të Drejtorive Rajonale janë marrë masa administrative konform kërkesave ligjore për produkt të pasigurt, bllokim produkti me destinacion asgjesimin, si dhe ka vazhduar në ndjekjen e gjurmueshmërisë së produktit prej nga ishte prodhuar duke shkuar deri në nivel fermeri.”

Në vijim të përgjigjes së sipërcituar, gjithashtu dhe në mungesë të një përgjigje për kërkesën e dytë, ankuesja, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji, konkretisht, urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të kërkuar sipas pikës 3 të kërkesës për informacion datë 03.04.2025, si dhe datë 22.04.2025.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesave, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në to, vlerësoi se ankesat përmbushin kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”, Komisioneri nëpërmjet shkresave me nr. 1276/1 prot., datë 28.04.2025 dhe nr.1371/1 prot., datë 13.05.2025, ka kërkuar nga Autoriteti Publik të informohet mbi trajtimin, apo procedurën e ndjekur, lidhur me kërkesat për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik, nëpërmjet shkresës me nr. 2842/1 prot., datë 21.05.2025, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1371/2 prot., datë 26.05.2025, ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: “...Së pari, institucioni është përballur me një fluks të lartë kërkesash nga gazetarë të ndryshëm, por jo vetëm për të cilat shqyrtimi i kërkesës është i pa mundur brenda afatit 10 ditor, duke kërkuar kështu edhe mirëkuptimin nga ana e tyre, pasi të gjitha materialet e kërkuara janë voluminozë dhe kërkohet kohë më e gjatë për përpunimin e informacionit të cilin nuk e disponojmë ende në sisteme të dixhitalizuara që mund të lehtësoheshe gjenerimi i të dhënave, si dhe sjellim në vëmendje se, përveç kthimeve të përgjigjeve për të drejtën e informimit, misioni i AKU i cili është të garantojë sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve dhe ushqimeve për kafshë në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet kryerjes së veprimtarisë inspektuese, teknike dhe shkencore në këtë fushë. Së dyti, në përgjigje të kërkesës së Televizionit “Ora News”, nr. 44 prot., datë 22.04.2024, i është kthyer përgjigje nga adresa elektronike Besjan.Osmanaj@aku.gov.al, për të cilën ju vëmë në dispozicion kopje të emailit.”

Konkretisht, nëpërmjet e-mail-it datë 14.05.2025, Autoriteti Publik ka sqaruar ankuesen se: “Në përgjigje të kërkesave tuaj trajtojmë paraprakisht se në zbatim të kërkesave ligjore trajtohet se:

- *“Kontroll zyrtar” është çdo kontroll për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë...*

Në kuadër të planeve zyrtare të marrjes së mostrës me bazë risku, trupat inspektuese kanë marrë dhe kanë analizuar kampione në përmbushje të detyrimeve të sipër cituara, si dhe referuar udhëzimit nr. 18, datë 23.6.2022 “Rregullore e procedurave të inspektimit”, kreu VIII “marrja e mostrave” përcakton rastin kur procedohet me bllokimin e produktit i cili është ai rast kur trupa inspektuese ka dyshim për shkelje të kërkesave ligjore.

- *Mostrat e qumështit janë marrë në tregtim dhe përpunim në mënyrë rastësore të prodhuara nga subjekte të ndryshme ku sipas legjislacionit në fuqi janë marrë të gjitha masat duke ndjekur gjurmueshmërinë deri tek fermeri.*
- *Në lidhje me mostrat të cilat kanë rezultuar jo konforme për praninë e Aflatoksinës M1 nga ana e trupave inspektuese të Drejtorive Rajonale janë marrë masa administrative konform kërkesave ligjore për produkt të pasigurt, bllokim produkti me destinacion asgjësimin, si dhe ka vazhduar në ndjekjen e gjurmueshmërisë së produktit lëndë e parë prej nga ishte prodhuar duke shkuar deri në nivel fermeri.*
- *Procedura e Asgjësimit të produkteve ushqimore kryhet në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9863 “Për Ushqimin”, i ndryshuar specifikisht në nenin 69 “Bllokimi dhe asgjësimi i ushqimit dhe ushqimit për kafshë” të tij citohet: “Ushqimi dhe ushqimi për kafshë, që nuk plotëson kërkesat e këtij ligji dhe që është bllokuar ose hequr nga tregu, asgjësohet me procesverbal të rregullt, sipas mënyrave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e mjedisit dhe shpenzimet përballohen nga operatori i biznesit ushqimor ose operatori i biznesit të ushqimit për kafshë, që ka bërë shkeljen”.*
- *Subjekti njofton DRAKU-në përkatëse (me anë të kërkesës) për të marrë pjesë në asgjësimin e produktit të bllokuara nga AKU si dhe subjekti në të njëjtën kohë duhet të njoftojnë edhe Drejtorinë përkatëse të Tatimeve dhe Inspektoratin e Mjedisit (AKM), në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, për nisjen e procedurës së asgjësimit për të cilën jemi në pritje dhe produkti vijon të qëndrojë i bllokuar në ambintet e subjektit.”*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja ka vijuar ankimin pranë Komisionerit, regjistruar me nr. 1276/2 prot., datë 08.05.2025, gjithashtu me e-mail-in datë 15.05.2025, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit për pikën 3 të kërkesës për informacion datë 03.04.2025, si dhe informacionin e plotë lidhur me kërkesën e datës 22.04.2025.

Në këto kushte, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 116 dhe

nr. 117, datë 02.06.2025, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik.

Pranë Autoritetit Publik u depozituan urdhrat e inspektimit administrativ, të cilët u protokolluan me nr. 3105 prot. dhe nr. 3106 datë 04.06.2025.

Gjatë inspektimit, grupi i inspektimit kontaktoi me koordinatorin për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, i cili, sqaroi se: *“Referuar kërkesës për informacion të datës 03.04.2025 kërkesa i është përcjellë strukturës përgjegjëse brenda afateve ligjore. Me datë 11.04.2025 nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut më ka ardhur përgjigja e cila i është dërguar në kohë znj. me datë 11.04.2025. Lidhur me vijimin e ankesës së znj. për pikën 3 nga struktura përgjegjëse është gjykuar të trajtohet me kërkesën e datës 22.04.2025 duke qenë se përsëritet në këtë kërkesë. Përgjigje kjo që i është dërguar znj. me datë 15.05.2025.”*

Ndërkohë, referuar kërkesës datë 22.4.2025 sqaroi se: *“...më datën 23.4.2025 kërkesa është përcjellë tek struktura përgjegjëse që është Sektori Koordinimit dhe Kontrollit Zyrtar i Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe Operatorëve të Biznesit Ushqimor. Me datën 14.5.2025 ka ardhur një e-mail në lidhje informacionin e kërkuar të cilin i cili i është përcjellë znj. me datë 15.5.2025.”*

Për sa më sipër, grupi i inspektimit, kërkoi të informohet nëse dokumentacioni i kërkuar disponohet nga Autoriteti Publik, si dhe për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi. Në këto kushte kërkoi të kontaktoj me përfaqësuesin e Autoritetit Publik, pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut, i cili sqaroi se: *“AKU e disponon informacionin por është gjykuar e panevojshme dhënia e këtij informacioni pasi, si edhe është përmendur më sipër, janë marë të gjitha masat e duhura, konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, për garantimin e sigurisë ushqimore, edhe në nivel ndër institucional, duke bashkëpunuar me të gjitha institucionet në varësi të MBZHR-së, të cilat janë pjesë e zinxhirit të garantimit të sigurisë ushqimore (AKVMB, ISUV).”*

Në përfundim të inspektimit u lexua procesverbali nga të pranishmit dhe pasi u gjet i shkruar drejtë, u nënshkrua rregullisht nga të dyja palët.

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, qëndrimin të mbajtur nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, argumentet e parashtruara për ankesat objekt shqyrtimi, nuk janë në përputhje me dispozitat e LDI.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”*. Në kuptim të këtij parashikimi, Autoriteti Kombëtar

i Ushqimit është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në pikën 1 të nenit 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet publik pavarësisht nëse është në cilësinë e “prodhuesit” apo “mbajtësit” të informacionit, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë.*

Komisioneri, konstaton se, nga përgjigja e kthyer nëpërmjet e-mail-eve, datë 11.04.2025, 14.05.2025 dhe 15.05.2025, Autoriteti Publik nuk ka vendosur në dispozicion të ankueses, informacionin/dokumentacionin sipas kërkesave për informacion, por ka sqaruar vetëm në lidhje me procedurat ligjore që ky i fundit ndjek në zbatim të legjislacionit të posaçëm.

Gjatë inspektimit, Autoriteti Publik ka deklaruar se, duke qenë se tashmë ka ndërmarrë të gjitha hapat ligjore për të eliminuar risqet dhe se përhapja e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, do të mund të shkaktoje një gjendje paniku të panevojshme pranë konsumatorëve, ky informacion është gjykuar të mos vendoset në dispozicion. Argument ky i cili nuk rezulton të jetë në përputhje me parashikimet e LDI.

Në këto kushte, Komisioneri thekson se kërkesa për informacion, në rastin konkret, lidhet me dokumenta që përmbajnë informacion për procedurat e asgjësimit të produkteve ushqimore, të kryera në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9863, datë 28.01.2008 *“Për ushqimin”*, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, informacion ky i cili lidhet me sigurinë ushqimore dhe rrjedhimisht përbën interes për publikun.

Ndërkohë, LDI rregullon dhënien e aksesit në informacionin publik për çdo person të interesuar. Ky ligj, në nenin 17 të tij përcakton dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar. Në këto raste, Autoriteti Publik duhet të tregojë qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që refuzohen, si dhe në bazë të cilës pikë të nenit 17 bëhet ky refuzim. Nga verifikimi i përgjigjes së Autoritetit Publik, nuk rezulton të jetë argumentuar refuzimi i kërkesës në përputhje me këtë nen.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik, për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 2, të neni 2 të LDI, ku parashikohet se: *“Informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni objekt shqyrtimi, përbën informacion publik

dhe bazuar në dispozitat e sipërcituara duhet të vendoset në dispozicion të ankueses në formatin e zotëruar, duke mbajtur në konsideratë kufizimet sipas nenit 17 të LDI.

Si përfundim, Komisioneri thekson se LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: *“Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”*.

Gjithashtu, ankuesja është gazetareske, e cila synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen *“Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisë”*, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias, ose në fusha të ndërlidhura me të, të realizojnë punën e *“mbikëqyrësit shoqëror”*, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informacione të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesave të Televizionit “Ora News”, përfaqësuar nga znj. _____, me nr. 1276 prot., datë 22.04.2025 dhe nr. 1371 prot., datë 12.05.2025, ndaj Autoritetit Publik, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit me objekt *“Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare”*.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit sipas pikës 3 të kërkesës për informacion nr. 37 datë 03.04.2025, konkretisht: *“3. Nëse po, lutem të na informoni në mënyrë specifike se te cilat mostra qumështi ka rezultuar niveli i lartë i aflatoksinës?”*, si dhe kërkesës për informacion nr. 44, datë 22.04.2025, konkretisht: *“1. Te cilat mostra qumështi u konstatua prania e Aflatoksinës M1? 2. Sa ka qenë sasia totale e qumështit me Aflatoksinë nga janri deri në prill 2025? 3. Sa u shit? 4. Sa është në total sasia e qumështit të bllokuar e cila do të asgjësohet? 5. Deri në këtë moment sa qumësht është asgjësuar? 6. Çfarë*

masash administrative u morën ndaj subjekteve që hodhën në treg produktin e pasigurt? ”, brenda datës 27.06.2025.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 20.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi